



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
MINISTRI

Nr. 19108 prot.

Data: 6, 10, 2023

VENDIM

Nr. 74, Datë 6, 10, 2023

PËR

VLERËSIMIN NË KUADËR TË HEQJES SË AKREDITIMIT ME KUSHT PËR  
OFRUESIN PUBLIK TË AFP-SË, SHKOLLA E MESME  
TEKNOLOGJIKE "HYSEN ÇELA" DURRËS

Bazuar në ligjin nr. 23/2018 për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10 247, datë 4.3.2010, "Për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve", në pikën 1, 3 të nenit 24 të ligjin nr. 69/2012 "Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar me ligjin nr.56/2015, datë 28.5.2015, nr. 48/2018, datë 23.7.2018; në pikën 2 të nenit 25, të ligjit nr. 15/2017, datë 16.02.2017, "Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë", në zbatim të urdhrimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.128 datë 6.7.2021 për miratimin e "Rregullores për Standardet, Kriteret dhe Procedurat e Akreditimit të Ofruesve të Arsimit dhe Formimit Profesional", Neni 23 dhe neni 24, pika 2/d).

VENDOSI:

1. Ofruesi publik i AFP-së Shkolla e Mesme Teknologjike "Hysen Çela", Durrës, i ka plotësuar kushtet e vendosura në Vendimin **Akreditim me kusht** nr. 4, datë 17.02.2023, me nr. 22386/1 prot. datë 17.02.2023 të MFE-së me afat vlefshmërie deri më 16.08.2023, për Kualifikimet profesionale të reja, sipas niveleve përkatëse në KSHK.

2. Mbështetur në Raportin e Monitorimit të Posaçëm dhe Urdhrin e miratimit të tij, i jepet vlerësimi përfundimtar pozitiv **akreditim i plotë** dhe heqjen e kushteve të akreditimit për kualifikimet profesionale si më poshtë:

1. "Hoteleri – Turizëm", Niveli II në KSHK, G-II-17
2. "Kuzhinë –Pastiçeri", Niveli III në KSHK, G2-III-16

3. “Bar Restorant”, Niveli III në KSHK, G1-III-18
4. “Shërbime në hotel dhe restorant”, Niveli III në KSHK, G5-III-18
5. “Hoteleri-Turizëm”, Niveli IV në KSHK, G-IV-20.

3. Afati përfundimtar i **akreditimit të plotë** është 4 vite, duke filluar nga data e firmosjes së këtij vendimi.

4. Bazuar në pikën 1/a të nenit 18 të Urdhrit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.128 datë 6.7.2021<sup>\*</sup> për miratimin e “Rregullores për Standardet, Kriteret dhe Procedurat e Akreditimit të Ofruesve të Arsimit dhe Formimit Profesional” Ofruesi publik i AFP-së Shkolla e Mesme Teknologjike, “Hysen Çela”, Durrës, do t’i nënshtrohet vlerësimit të jashtëm çdo 4 vjet periodikisht, në kuadër të procesit të akreditimit institucional.

5. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve për zbatimin e këtij vendimi, publikimin dhe lëshimin e certifikatës së akreditimit të plotë, brenda një muaji nga data e marrjes së këtij vendimi, si dhe monitorimin e vazhdueshëm, për të garantuar qëndrueshmërinë e përmirësimeve të reflektuara në kuadër të plotësisimit të kriterëve dhe veçanërisht ato që lidhen me zbatimin e rekomandimeve të lëna në raportin përfundimtar të akreditimit.

6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.





REPUBLICA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT  
MINISTRI

Nr. 15233 prot.

Data: 23, 1, 2025

VENDIM

Nr. 19, Datë 23, 1, 2025

PËR

VLERËSIMIN NË KUADËR TË HEQJES SË AKREDITIMIT ME KUSHT PËR  
OFRUESIN PUBLIK TË AFP-SË, SHKOLLA E MESME  
TEKNOLOGJIKE "HYSEN ÇELA" DURRËS

Bazuar në pikën 2, të nenit 25, të ligjit nr. 15/2017, datë 16.2.2017. "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Urdhrit nr. 128, datë 06.07.2021, "Për miratimin e Rregullores për Standardet, Kriteret dhe Procedurat e Akreditimit të Ofruesve të Arsimit dhe Formimit Profesional", si dhe raportit të monitorimit të posaçëm për Skollën e Mesme Profesionale, Teknologjike "Hysen Çela" Durrës, dërguar nga AKAFPK me shkresën nr. 362/11prot.. datë 02.12.2024.

VENDOSI:

1. Ofruesi publik i AFP-së, Shkolla e Mesme Teknologjike "Hysen Çela", Durrës, i ka plotësuar kushtet e vendosura në Vendimin nr. 6571, datë 21.05.2024, të Ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, "Akreditim me kusht" me afat vlefshmërie deri më 20.11.2024.
2. Bazuar në Raportin e Monitorimit të Posaçëm dhe Urdhrit e miratimit të tij nr. 46 datë 02.12.2024, i jepet vlerësimi përfundimtar pozitiv "Akreditim i plotë" dhe heqjen e kushteve të akreditimit për kualifikimet profesionale si më poshtë vijon:
  - a) "Teknologji Ushqimore", Niveli II në KSHK, A-II-21;
  - b) "Teknologji e Përpunimit të Brumërave", Niveli III në KSHK, A1-III-22;
  - c) "Teknologji Ushqimore", Niveli IV në KSHK, A-IV-18;

- d) "Detari", Niveli II në KSHK, J-II-20;
- e) "Peshkim", Niveli III në KSHK, J1-III-21;
- f) "Detari", Niveli IV në KSHK, J-IV-17;
- g) "Tekstil – Konfeksione", Niveli II në KSHK, D-II-17;
- h) "Rrobaqepësi", Niveli III në KSHK, D1-III-19;
- i) "Tekstil – Konfeksione", Niveli IV në KSHK, D-IV-19;
- j) "Ekonomi Biznes", Niveli II në KSHK, L-II-21;
- k) "Llogari", Niveli IV në KSHK, L4-IV-19;

3. Afati përfundimtar i "Akreditimit të plotë" është 4 vite, duke filluar nga data e firmosjes së këtij vendimi.

4. Bazuar në pikën 1/a të nenit 18 të Urdhrit nr.128 datë 6.7.2021 "Për miratimin e Rregullores për Standardet, Kriteret dhe Procedurat e Akreditimit të Ofruesve të Arsimit dhe Formimit Profesional", ofruesi publik i AFP-së, Shkolla e Mesme Teknologjike, "Hysen Çela", Durrës, do t'i nënshtrohet vlerësimit të jashtëm çdo 4 vjet periodikisht, në kuadër të procesit të akreditimit institucional.

5. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve për zbatimin e këtij vendimi, publikimin dhe lëshimin e certifikatës së akreditimit të plotë, brenda një muaji nga data e marrjes së këtij vendimi, si dhe monitorimin e vazhdueshëm, për të garantuar qëndrueshmërinë e përmirësimeve të reflektuara në kuadër të plotësisimit të kritereve dhe veçanërisht ato që lidhen me zbatimin e rekomandimeve të lëna në raportin përfundimtar të akreditimit.

6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR  
Blendi GONXHJA





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT**  
**AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT, FORMIMIT PROFESIONAL DHE KUALIFIKIMEVE**

Nr. 249/2 Prot.

Tiranë, më 17.6 2026

**URDHËR**

Nr. 36, datë 17.6 2026

**PËR**

**MIRATIMIN E RAPORTIT TË MONITORIMIT DHE RIFRESKIMIN E  
CERTIFIKATËS SË AKREDITIMIT ME KUALIFIKIME TË REJA TË PLOTA PËR  
SHKOLLËN E MESME TEKNOLOGJIKE “HYSEN ÇELA”, DURRËS**

Bazuar në ligjin nr. 10 247, datë 4.3.2010, “Për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve” i ndryshuar; në ligjin nr. 69/2012 “Për Sistemin Arsimit Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në pikën 2 të nenit 25, të ligjit nr. 15/2017, datë 16.02.2017, “Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar; në Urdhrin nr. 156, datë 04.03.2026 për disa shtesa dhe ndryshime në urdhrin nr. 99, datë 25.5.2021, “Për miratimin e Katalogut Kombëtar të Kualifikimeve Profesionale” i ndryshuar, si dhe në zbatim të urdhrit të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit nr. 845 datë 3.7.2025 për miratimin e “Rregullores për Standardet, Kriteret dhe Procedurat e Akreditimit të Ofruesve të Arsimit dhe Formimit Profesional”, neni 8, pika 1, 6 dhe 7, neni 25, pika 1, 2 dhe pika 3 gërma a), neni 26 pika 1 dhe 2, gërma d), dhe neni 27 pika 6”,

**URDHËROJ:**

1. Miratimin e raportit të monitorimit për Shkollën e Mesme Teknologjike “Hysen Çela”, Durrës. Rifreskimin e të dhënave të certifikatës së akreditimit për të pasqyruar shtimin e kualifikimeve profesionale si më poshtë:

- “Dizenjim mode”, Niveli V në KSHK, D1-V-25
- “Kontroll laboratorik i ushqimit”, Niveli V në KSHK, A1-V-14
- “Kuzhinë” (Arsim i dyfishtë), Niveli III në KSHK G8-III-24
- “Menaxhim i strukturave akomoduese” (Arsim i dyfishtë), Niveli V në KSHK, G1-V-24

2. Certifikatat e mëparshme të akreditimit të revokohen dhe të zëvendësohen me certifikatën e rifreskuar.
3. Certifikata e akreditimit e rifreskuar hyn në fuqi në datën e lëshimit dhe ka të njëjtin afat vlefshmërie me certifikatën e mëparshme të akreditimit, sipas vendimit të fundit të MEKI nr. 19 datë 23.01.2025.
4. Ngarkohet Sektori i Akreditimit të Ofruesve të AFP-së për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**Ejvis GISHTI**

